



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.46 dt.27.03.1998

**“MBI
DISA MASA PER NDALIMIN E VEPRIMTARIVE TREGTARE
AMBULANTE NE QENDER TE TIRANES”**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, pasi mori në shqyrtim relacionin e Drejtorisë së Kulturës dhe Drejtorisë së Shërbimeve Publike “Mbi disa masa për ndalimin e veprimtarive tregtare ambulante në Qendër të Tiranës”

VENDOSI

1. Të mos lejohen veprimtari tregtare ambulante të çfarëdo lloji për tokë, në trotuar si dhe lypës (fëmijë, sakatë) në qendër të Tiranës, Sheshin Skënderbej ku përfshihen : Muzeu Historik Kombëtar, Hotel Tirana, Hotel Miniri, Teatri i Operas, Pallati i Kulturës, Xhamia dhe Sahati, Bashkia e Tiranës.
Të gjitha Ministritë, Galeria e Arteve, Hotel Dajti, Teatri i Kukullave, Banka e Shtetit Shqiptar.
2. Të mos lejohet asnjë veprimtari shitje të çfarëdo lloji dhe lodra të ndryshme në platformën ku ndodhet shtiza e flamurit kombëtar dhe monumenti i Skënderbeut.
3. Ndërmarrja e Gjelbërimit të marrë masa që brenda muajit Prill 1998 të gjelbërohen dhe të mbillen lule në lulishten përbri monumentit të Skënderbeut dhe të pastrohen gurët e piedestalet.

4. Organet kompetente të policisë të Tiranës të garantojë zbatimin e pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI